

shtator 2024

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin gusht

2024

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin gusht

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, shtator 2024

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

01.

Publikimet në gjuhën shqipe

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ
Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese
Llojet e fushave tematike
Llojet e publikuesve
Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe
Llojet e mediave sociale
Figurat dhe Institucionet më të përfolura

02.

Publikimet në gjuhën serbe

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ
Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese
Llojet e fushave tematike
Llojet e publikuesve
Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe
Llojet e mediave sociale
Figurat dhe Institucionet më të përfolura

03.

Kontrulli dhe vlerësimi i deklaratave

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkruës pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë gushtit 2024, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është i pari dhe i vetmi i llojit. Është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i 24-të mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma hibrid.info e specializuar në kontroll të fakteve, edukim digjital dhe medial, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e përmbajtjeve me karakter informues për dhe rreth ngjarjeve në Kosovë. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:

- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.


Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info, e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe (të tjera)

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE

Publikimet në gjuhën serbe
18%



Publikimet në gjuhën shqipe
82%

Mostra e monitorimit dhe trajtimit të përmbajtjeve keqinformuese nga platforma “hibrid.info” fokusohet në keqinformimet në gjuhën shqipe, të publikuara në media, portale të dyshimta, si dhe faqe dhe llogari në mediat sociale. Si rezultat, gjatë muajit maj 2024, publikimet në këtë gjuhë përbënin 71% të rasteve të trajtuara.

Gjatë këtij muaji, në kuadër të monitorimit, janë trajtuar 71 përmbajtje, ku 58 (82%) prej tyre ishin në gjuhën shqipe ndërsa 13 (18%) në gjuhën serbe.

1

Publikimet në gjuhën shqipe

Gjatë analizës së përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe për muajin gusht 2024, është evidentuar se 82% e 71 përmbajtjeve të identifikuara ishin në këtë gjuhë. Kategoria më e shpeshtë e keqinformimit ishte “lajm i rremë”, e cila përbënte 31% të totalit, duke shënuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me 6% në korrik. Pjesa tjetër e përmbajtjeve përfshinte clickbait (7%), dezinformata (6%) dhe kombinime të tyre. Lajmet e rreme shpërndareshin kryesisht në platforma si Facebook dhe TikTok, duke trajtuar tema të ndjeshme si armatosja e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe ngjarjet politike lidhur me urën e Ibrit.

Gjatë këtij muaji, u vërejt një rritje e theksuar e përmbajtjeve të lidhura me sigurinë dhe politikën, ku këto dy fusha përbënin 27% të gjithë raporteve për keqinformim. Në veçanti, tema e armatosjes së FSK-së dominuar me 13% të përmbajtjeve, duke shfaqur një tendencë të qartë për shpërndarjen e informacionit të pasaktë në lidhje me këtë institucion. Rasti i Faton Hajrizit gjithashtu mori vëmendje, duke u përdorur si bazë për përhapjen e dezinformatave.

Në aspektin e mediave sociale, Facebook vazhdoi të jetë platforma kryesore për shpërndarjen e lajmeve të rreme, duke mbajtur 31% të totalit të përmbajtjeve. TikTok gjithashtu tregoi një rritje, duke zënë 23% të publikimeve, ndërsa X (ish-Twitter) dhe Instagram kishin një prani më të vogël në këtë kontekst. Analiza e llojeve të publikuesve zbuloi se 58% e informacionit të keq ishte shpërndarë në mediat sociale, me Facebook dhe TikTok që dominonin në këtë aspekt.

Përqindja e përmbajtjeve në
gjuhën shqipe




Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

1.1

KATEGORITË KRYESORE


Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Në përputhje me gjetjet e analizës së 61 përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe për muajin gusht 2024, është vërejtur se lajmet e rreme përbëjnë kategorinë më të shpeshtë të keqinformimit, duke zënë 31% të totalit. Pas tyre, përmbajtjet clickbait përfaqësojnë 7%, ndërsa dezinformatat dhe dezinformatat/clickbait kapin 6%.

Muaji gusht ka evidentuar një rritje të theksuar të lajmeve të rreme, të cilat arritën në 31%, duke u krahasuar me vetëm 6% në korrik. Kjo rritje sugjeron një fokus të intensifikuar në shpërndarjen e informacionit të rreme, duke e bërë atë kategorinë kryesore të keqinformimit për këtë periudhë.

Nga ana tjetër, clickbait, e cila kishte një përqindje të lartë prej 19% në korrik, përjetoi një rënie të dukshme në 7% në gusht, duke treguar ndryshime të strategjive të përmbajtjes. Edhe dezinformatat panë një ulje të vogël, duke reflektuar një ndryshim në dinamikën e përmbajtjeve keqinformuese gjatë këtyre dy muajve.



36% e artikujve keqinformues të trajtuar kanë marrë vlerësimin “lajm i rremë”.

1.1.1.

Analizë e llojeve të vlerësimeve

01. Lajm i rremë

Të gjitha lajmet e rreme janë shpërndarë përmes faqeve dhe llogarive në platforma të ndryshme mediatike, përfshirë Facebook, TikTok, X dhe Instagram. Kryesisht, përmbajtjet e lajmeve të rreme kanë përfshirë tema nga fusha e sigurisë (15%) dhe politika (10%). Dy temat kryesore që janë shoqëruar me lajmet e rreme janë: armatosja e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe përmbajtjet lidhur me urën e lbrit.

03. Dezinformatë

Dezinformatat janë publikuar në mediat sociale (4%) dhe në mediat reale (1%). Në mediat tradicionale është shpërndarë një dezinformata nga fusha e sigurisë, e cila pretendon se KFOR-i është larguar nga ura e lbrit. Ndërkohë, në mediat sociale janë publikuar dezinformatat me pretendimet se Vasfije Krasniqi-Goodman ka kërkuar llogari nga komandantët e UÇK-së, si dhe një video e vjetër që tregon ushtarët amerikanë pranë liqenit të Ujmanit.

02. Clickbait

Artikujt clickbait janë shpërndarë në mediat tradicionale. Kryesisht, ata fokusohen në tema që lidhen me katastrofat natyrore, duke përfshirë publikime për tërmete dhe raste tragjike, për të cilat nuk jepet informacion mbi vendndodhjen e ngjarjes. Gjithashtu, nga fusha e politikës është publikuar si aktuale një letër e vitit 2019 nga presidenti Joe Biden drejtuar ish-presidentit Hashim Thaçi.

04. Dezinformatë / Clickbait

Përmbajtjet e kategorizuara si dezinformata/clickbait janë shpërndarë kryesisht në mediat reale. Këto përmbajtje përfshijnë tema nga fusha politike, si urën e lbrit dhe zgjedhjet në Kosovë, si dhe aspekte nga fusha e sigurisë që lidhen me veriun e vendit.


Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: Lajm i rremë/Mashtrim, Gabim, Mashtrim, Përmbajtje e paverifikuar, Teori konspirative, Manipulim i fakteve, Manipulim i fakteve/Dezinformatë, Mashtrim/Lajm i rremë, Transmetim i lajmeve të rreme, Mashtrim/Përmbajtje e paverifikuar, Clickbait/Mashtrim, Clickbait/Dezinformatë, Mashtrim/Dezinformatë.

1.2

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave




Diskutimi rreth çështjeve të sigurisë dhe luftës në sferën politike ka çuar në një shpërthim të përmbajtjeve keqinformuese në mediat sociale, veçanërisht në lidhje me armatosjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Kjo temë vazhdon të jetë objekt diskutimi dhe përhapjeje dezinformatash, duke përfshirë edhe muajin gusht. Gjatë këtij muaji, armatosja e FSK-së ka dominuar me 13% të përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe.

Retorika politike gjatë muajit gusht lidhur me mundësinë e hapjes së urës së lbrit për qarkullimin e automjeteve ka nxitur publikimin e keqinformacioneve në lidhje me këtë çështje. Si rezultat, kjo temë renditet si e dyta në listën e temave më të diskutueshme për muajin gusht.

Rasti i Faton Hajririt, i cili u bë i dyshuar për vrasjen e një zyrtari policor në Serbi pas arratisjes së tij më 6 korrik dhe u vra gjatë përpjekjes për t'u arratisur, vazhdoi të përdoret si temë për keqinformata gjatë muajit gusht 2024, duke tërhequr një vëmendje.

Temat e tjera për të cilat është përhapur keqinformimi gjatë gushtit përfshijnë Veriun, tërmetet, Kamala Harris dhe Kosovën, si dhe zgjedhjet në Kosovë.



33% e temave kryesore janë për armatosjen e FSK-së, ura e lbrit, rasti i Faton Hajririt, veriu, zgjedhje në Kosovë.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

1.2.1.

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hybrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Armatosja e FSK-së

Të gjitha keqinformata lidhur me armatosjen e FSK-së janë publikuar në media sociale (Facebook dhe TikTok). Këto përmbajtje keqinformuese nga fusha e sigurisë kryesisht janë vlerësuar si lajm i rremë. Në media sociale kanë qarkulluar pretendime të rreme për pajisjen e FSK-së me artileri të rëndë, si tanke, helikopter etj.

02. Ura e Ibrit

Keqinformata lidhur me zhvillimet rreth urës së Ibrit janë publikuar në mediat sociale (6%) dhe në mediat tradicionale (4%). Temat kryesore lidhen me fushën e politikës dhe janë kategorizuar kryesisht si lajme të rreme. Në kuadër të kësaj janë publikuar pretendime të rreme se ura është hapur, se KFOR-i është larguar nga ura, se disa shtete po e përkrahin hapjen e urës etj.

03. Rasti i Faton Hajrimit

0.1. Të gjitha keqinformatat e publikuara për rastin e Faton Hajrimit janë shpërndarë në mediat sociale, si Facebook dhe TikTok. Këto përmbajtje keqinformuese kanë qenë të lidhura me fushën e sigurisë dhe janë vlerësuar kryesisht si lajme të rreme. Në mediat sociale kanë qarkulluar pretendime të rreme se ai është gjallë, se analiza e strishos së nënës së Faton Hajrimit nuk përputhet me të dhënat e personit të vrarë në Serbi, dhe se janë publikuar pamjet e dhomës së burgut.

03. Veriu


Keqinformata lidhur me veriun janë publikuar si në mediat reale ashtu edhe në mediat sociale. Në mediat reale, u publikua një artikull me titullin që pretendonte se ushtria serbe kishte hyrë në Kosovë, i cili ishte në shpërputhje me përmbajtjen dhe u vlerësua si dezinformatë/clickbait. Ndërkohë, në mediat sociale u shpërnda si aktuale një video e vjetër (nga viti 2018) në të cilën shihen ushtarët amerikanë pranë liqenit të Ujmanit, e cila u kategorizua gjithashtu si dezinformatë.

1.3

Llojet e fushave

Si rezultat i gjetjeve të përmbajtjet keqinformuese të trajtuara gjatë muajit qershor del se publikues të ndryshëm (media reale dhe mediat sociale) kanë prodhuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën e politikës.

FUSHAT KRYESORE
Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore




Në një krahasim të temave të raportuara gjatë gushtit dhe korrikut, vërehet një rritje e dukshme e interesit për politikën dhe sigurinë. Në gusht, përqindja e raportimeve për politikën arriti në 27%, duke shënuar një rritje nga 20% që ishte në korrik.

Po ashtu, temat e sigurisë u theksuan më shumë, me 27% në gusht krahasuar me 13% në korrik.

Në kontrast, temat sociale panë një rënie të ndjeshme, duke zbritur nga 26% në 11%. Ndërkohë, raportimet për shëndetësinë ishin minimale, me vetëm 4% në gusht, dhe kronika e zezë gjithashtu pati një rënie, duke zënë 3% krahasuar me 6% në korrik.

Këto ndryshime reflektojnë një fokus të ndryshuar të medias, duke u orientuar më shumë drejt politikës dhe sigurisë gjatë muajit të fundit.



65% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë nga fusha e sigurisë, politikës dhe sociale.



Llojet e publikuesve

1.4

Bazuar në analizat e përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe, është e qartë se keqinformimi nga faqe dhe llogari në mediat sociale vazhdon të dominojë edhe gjatë muajit gusht. Kjo situatë tregon një trend në rritje të shpërndarjes së informacionit të pasaktë dhe të manipuluar, i cili shpesh përfshin mashtrime, dezinformatat, teori konspirative dhe lajme të rreme. Në këtë kontekst, përqindjet tregojnë se 58% e informacionit të keq është shpërndarë në mediat sociale, ndërsa lajmet e rreme përbëjnë 31%. Gjithashtu, dezinformatat dhe lajmet e rreme/mashtrimet zënë nga 4% secila, duke e theksuar edhe më shumë përhapjen e këtij fenomeni.

Në mediat reale, disa kategori të përmbajtjeve shpesh shfaqen duke ndikuar në cilësinë e informacionit që publikohet. Clickbait-i, që përbën 4% të përmbajtjes, përdoret për të tërhequr vëmendjen e lexuesve, shpesh pa korrespondim të përmbajtjes me titujt e artikujve. Një përqindje tjetër prej 4% përfshin kombinimin e dezinformatave me clickbait, ku titujt e artikujve janë çorientues që mund të çojnë në dezinformim të lexuesit.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE



58% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit në media sociale

Llojet e mediave sociale


1.5

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Sipas monitorimit të realizuar në gusht, është konstatuar se përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe janë shpërndarë gjerësisht në disa platforma sociale, ku Facebook ka mbizotëruar me 31% të të gjitha publikimeve. Ky fakt tregon se Facebook vazhdon të luajë një rol kyç në përhapjen e informacionit të pasaktë dhe keqinformimeve, duke ofruar një mjedis të gjerë ku përdoruesit mund të ndajnë dhe publikojnë përmbajtje të këtij lloji.

Përveç Facebook-ut, TikTok zuri 23% të publikimeve, duke pasqyruar një rritje të dukshme në përdorimin e kësaj platforme, për të shpërndarë një gamë të gjerë informacionesh, përfshirë edhe ato të pasakta. Ndërkohë, X (ish-Twitter) zë vetëm 3% të përmbajtjeve të shpërndara, duke pasur një ndikim shumë më të kufizuar. Instagrami, edhe pse një platformë e madhe sociale, përbën vetëm 1% të totalit, duke reflektuar një rol të vogël në shpërndarjen e përmbajtjeve në këtë kontekst.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË
MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

1.6

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Sipas të dhënave, Facebook përfaqëson 31% të totalit të përmbajtjeve të shpërndara në gjuhën shqipe, ku 28% janë faqe argëtuese (fun pages), 1% janë faqe zyrtare dhe 1% përfaqëson media. TikTok zë 23% të totalit, i përbërë tërësisht nga llogari personale. Instagram ka një përfaqësim minimal prej 1%, që përfshin vetëm faqe argëtuese. Ndërkohë, X (ish-Twitter) përbën 3% të përmbajtjes, e përbërë vetëm nga llogari personale. Kjo tregon se Facebook dhe TikTok janë platformat kryesore për shpërndarjen e përmbajtjeve në gjuhën shqipe, ndërsa Instagram dhe X kanë një prani më të kufizuar.



1.6.1.

Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

01. Facebook

Lajmet e rreme dhe ato të vlerësuara si lajm i rremë/mashtrim janë dy kategoritë kryesore me të cilat u vlerësuan keqinformatat e publikuara në Facebook. Siguria (11%), socialja (7%) janë dy fushat kryesore, për të cilat u keqinformua gjatë muajit gusht në Facebook. Temat kryesore për të cilat u keqinformuar më së shumti në Facebook janë armatosja e FSK-së, rasti i Faton Hajrizit dhe keqinformatat për hapjen e urës së Ibrit.


02. TikTok

Lajmet e rreme (17%) janë kategoritë që kanë dominuar në vlerësimin e përmbajtjeve keqinformuese. Sa i përket fushave, politika (8%) dhe siguria (8%) janë dy fushat për të cilat u keqinformua më së shumti në platformën TikTok. Armatosja e FSK-së dhe sondazhet zgjedhore janë dy temat për të cilat u keqinformua më së shumti në TikTok.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

1.7.

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.



Bazuar në 59 përmbajtjet keqinformuese të gjetura dhe trajtuara gjatë muajit gusht 2024, rezulton se në 27 përmbajtje janë përmendur institucionet të ndryshme.


FSK, KFOR-i dhe BE-ja janë tre institucionet më të përfolura në përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe.

FSK-ja është përmendur 10 herë (14%), në keqinformatat që ndërlidhen me pretendimet e pasakta për artmatasojen e këtij institucioni me artileri të rëndë.

KFOR-i është përmendur në 4 keqinformata (6%) që ndërlidhen me diskutimin për hapjen e urës së Ibrit, e që u pretendua pasaktësisht se KFOR-i është larguar nga ura, se Macron do t'i tërheq trupa franceze të KFOR-it nga ura etj.

Institucioni i BE-së është përfolur në 3 keqinformata në gjuhën shqipe, me pretendime të pasakta se BE-ja ia ka premtuar Serbisë mos-hapjen e Urës së Ibrit, se BE e ka përkrahur hapjen e urës së Ibrit.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Albin Kurti në kontekst me personalitete tjera është figura më e përfolur në përmbajtjet keqinformuese të publikuara në gjuhën shqipe gjatë muajit gusht 2024.

Albin Kurti është përfolur në 10 raste të keqinformimit përfshirë këtu, përfole në pretendime të pasakta ndërlidhur me hapjen urës së Ibrit, rritjen e pensioneve, ndryshimin e flamurit të Kosovës, rritjen e punësimit.

Kurti është përfolur në konteskt me presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, ndërlidhur me armatosjen e FSK-së dhe hapjen e urës së Ibrit.

Kurti është përfolur me komandantin e KFOR-it, Ozkan Ulutas, në pretendimin se pas takimit që kanë pasur Ulutas të ketë thënë se “Ura e Ibrit është në Kosovë ajo duhet të hapet pa pyetur askënd”.

Kurti është përfolur me presidenten, Vjosa Osmani, në pretendimet e rreme se këta të dy janë konvertuar në fenë katolike.

Kurti është përfolur edhe me kandidatin për kryeministër nga radhët e PDK-së, Bedri Hamza në përmbajtjen keqinformuese, ku pretendohet se SHBA-të po e përkrahin Hamzën, duke i dhënë mesazh Kurtit.


2.

Publikimet në gjuhën serbe

Gjatë analizës së 71 përmbajtjeve keqinformuese, 13 prej tyre (18%) u identifikuan si të publikuara në gjuhën serbe.

Në bazë të gjetjeve dhe trajtimin e 13 përmbajtjeve keqinformuese gjatë muajit gusht 2024, është evidentuar se teoritë konspirative janë ato që kanë dominuar si kategori kryesore e keqinformimit me 8%. Kjo kategori pasohet nga dezinformatat me 7%.

KATEGORITË KRYESORE
Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese




Ka një narrativë konspirative në mediat serbe që pretendon se dënimi i Zlatkoviçit për nxitje të përçarjes është një strategji e Prishtinës për të shtypur dhe frikësuar serbët në Kosovë. Këto media, pa ofruar prova të qëndrueshme, sugjerojnë se kryeministri Kurti po i kërcënon serbët e Kosovës dhe se ndalimi i dinarit serb ka si qëllim dëbimin

e tyre. Gjithashtu, ato aludojnë se organizatori i protestës së shqiptarëve në Bujanoc ishte Kurti, duke e lidhur atë me ngjarje të tjera, siç është djegia e tri shtëpive të serbëve pranë Prizrenit, pa ndonjë fakt të qartë. Për më tepër, është pretenduar se Policia e Kosovës, gjatë arrestimit të katër serbëve, ka thyer dyert dhe ka rrahur ata në prani të fëmijëve dhe nipërve të tyre, duke e paraqitur situatën në një dritë të errët dhe të pasigurt. Këto akuza dhe spekulime krijojnë një atmosferë tensioni dhe dyshimi mes grupeve etnike në Kosovë.

Mediat serbe shpërndajnë dezinformata të ndryshme që lidhen me situatën në Kosovë, duke pretenduar se kryeministri Kurti dhe shërbimi inteligjent qëndrojnë pas "kërcënimeve" ndaj ambasadave serbe. Një medium tjetër në gjuhën serbe shpërndau informacione të gabuara duke thënë se civilët e vrarë në Masakrën e Reçakut ishin ushtarë të UÇK-së. Pa asnjë provë të fortë, ushtrimi fushor "Valor Shield 2024" lidhet me supozime për një sulm ndaj serbëve në Kosovë. Për më tepër, ka pretendime të rreme se gjatë lyerjes së murit afër urës së Ibrit është mbuluar me ngjyrë flamuri i Serbisë. Gjithashtu, "Lista Serbe" pretendon pa fakte se nënstacioni i ri i Policisë në Leposaviq do të përbëhet vetëm nga shqiptarët. Këto dezinformata kontribuojnë në krijimin e një atmosfere tensioni dhe mosbesimi mes komuniteteve etnike në rajon.

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave




Gjatë muajit gusht 2024, temat kryesore të përmbajtjeve keqinformuese të publikuara në gjuhën serbe përfshinin kryesisht çështje të ndërlidhura me Serbinë dhe veriun e Kosovës. Në analizën e përmbajtjeve të raportuara, Veriu zë 7% të fokusit, duke reflektuar situatën e ndjeshme në këtë rajon. Ura e Ibrit, një pikë strategjike, përbën 3% të përmbajtjes, duke nënvizuar rëndësinë e saj në kontekstin lokal. Gjithashtu, dëbimi i serbëve është përmendur në 3% të rasteve, duke shkaktuar shqetësim në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike.

Kërcënimi ndaj ambasadave serbe në Evropë përbën vetëm 1% të raportimeve, duke theksuar ndjeshmërinë e situatës ndërkombëtare. Për më tepër, vendbanimet me shumicë serbe janë përmendur gjithashtu në 1%, duke treguar interesin për statusin dhe sigurinë e këtyre komuniteteve.


FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore




Në analizën e përmbajtjeve të raportuara, tema e sigurisë përbën 11% të totalit, duke reflektuar rëndësinë e kësaj çështjeje në kontekstin aktual të situatës në Kosovë. Në anën tjetër, politika përbën 7% të përmbajtjes, duke ilustruar interesin për ngjarjet dhe zhvillimet politike që ndodhin. Këto shifra sugjerojnë se çështjet e sigurisë dhe politika janë dy nga temat kryesore që shqetësojnë opinionin publik dhe formojnë diskutimet në përmbajtjet keqinformues.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES TË PUBLIKUESVE ME PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE




PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE




Gjatë muajit korrik 2024, përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe u publikuan kryesisht në media tradicionale, që përbënë 11% të totalit, duke theksuar ndikimin e tyre në shpërndarjen e informacionit të pasaktë. Media sociale, nga ana tjetër, zuri 6% të përmbajtjeve të keqinformuara, duke reflektuar rolin e saj gjithnjë e në rritje në përhapjen e dezinformatave, veçanërisht mes përdoruesve më të rinj. Për më tepër, media të dyshimta përbënin vetëm 1% të publikimeve.

Në media sociale, Telegram kontribuuan me nga 3% secila, duke vazhduar të jenë burime të përhapjes së keqinformimit. Po ashtu, Facebook dhe platforma X (ish-Twitter) gjithashtu përbënte 1% të përmbajtjeve, duke treguar se këto platforma mbeten terrene të rëndësishme për përhapjen e

RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES



RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Nga 13 keqinformata të identifikuara gjatë muajit gusht 2024, në 13 prej tyre janë përmendur institucione të rëndësishme. Policia e Kosovës dhe Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe ishin më të përmendurat, secila në 2 raste (3%). Po ashtu, UÇK, FSK / Ushtria amerikane, Lista Srpska përmendën secila në nga 1 rast (1%).

Gjatë muajit gusht 2024, në teoritë konspirative që qarkulluan, Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe u përmend në lidhje me disa tema të rëndësishme. Njëra nga teoritë sugjeron se dënimi i Zlatkoviqit për nxitje të përçarjes është një strategji e Prishtinës për të shtypur dhe frikësuar serbët në Kosovë. Po ashtu, pa ofruar asnjë provë, pretendon se ndalimi i dinarit serb në Kosovë është një qëllim i kryeministrit Kurti për të dëbuar serbët nga rajoni.

Gjatë gushtit 2024, Policia e Kosovës u përfol në disa teori konspirative, duke tërhequr vëmendjen për situatën e tensionuar në rajon. Pa ndonjë fakt të qëndrueshëm, u pretendua se gjatë arrestimit të katër serbëve, Policia e Kosovës kishte keqtrajtuar ata. Për më tepër, është theksuar se regjistruarit e popullsisë dhe Policia e Kosovës nuk kanë shkuar në veri për të dënuar individët që refuzojnë të regjistrohen.


Gjatë muajit gusht 2024, personalitetet më të përmendura në përmbajtjet keqinformuese ishin kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili u përmend në 6 raste. Teoritë konspirative sugjerojnë se dënimi i Zlatkoviqit për nxitje të përçarjes është një strategji e Prishtinës për të shtypur dhe frikësuar serbët. Përveç kësaj, media serbe shpërndan dezinformata duke pretenduar se Kurti dhe shërbimi inteligjent qëndrojnë pas "kërcënimeve" ndaj ambasadave serbe, si dhe se ai po i kërcënon serbët në Kosovë. Një tjetër akuzë, gjithashtu pa baza, është se Kurti ishte organizatori i protestës së shqiptarëve në Bujanoc. Gjithashtu, pa asnjë provë, ushtrimi fushor "Valor Shield 2024" është lidhur me një supozim për sulm ndaj serbëve në Kosovë. Së fundmi, djegia e tri shtëpive të serbëve afër Prizrenit lidhet pa fakte me shqiptarët dhe kryeministrin Kurti, duke kontribuar kështu në një atmosferë tensioni dhe dyshimi mes grupeve etnike.

3.

Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave

Hibrid.info, përveç kontrollit dhe analizës së artikujve mediatik, bën edhe kontrollin dhe vlerësimin e deklaratave të zyrtarëve të lartë politikë e institucionalë, si dhe figurave që kanë ndikim publik. Vlerësimi i këtyre figurave, sipas metodologjisë së hibrid.info, bëhet në kategoritë e vërtetësisë, qëndrueshmërisë dhe përmbajtjes së premtimeve.

RENDITJA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT TË DEKLARATAVE



Në kuadër të përmbajtjes së monitoruar gjatë muajit gusht, hibrid.info ka kontrolluar dhe analizuar 1 deklaratë.

Policia e Kosovës më 5 gusht ka njoftuar se përmes një aksioni i ka mbyllur nëntë objekte të Postës së Serbisë në veri, më herët gjatë ditës.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq përmes një konference për media lidhur, foli rreth kësaj ngjarje, duke pretenduar se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti është duke u përpjekur për të provokuar një konflikt dhe se sipas tij, ai po e bën atë në mënyrë të organizuar me mbështetjen e disa fuqive perëndimore. Në Mitrovicë të Veriut dhe Leposaviq janë mbyllur nga tri objekte, në Zveçan dy, dhe një në Zubin Potok, raporton Radio Evropa e Lirë. Zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, ka thënë se aksioni ka nisur pas informatës së pranuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) se në territorin e Kosovës po operojnë operatorë ekonomikë pa licencë dhe që nuk janë të regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK). Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), ka bërë të ditur se Posta e Serbisë vepron ilegalisht në Kosovë.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në baza të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese njëmuajore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 30 gusht 2024, në të cilën janë trajtuar 71 përmbajtje keqinformuese.

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes një mujore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit gusht 2024, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Përfundime

Gjatë muajit gusht 2024, janë regjistruar 71 raste të përmbajtjeve keqinformuese në Kosovë, me një përqindje dominuese prej 82% që ishin në gjuhën shqipe. Kategoria më e shpeshtë e këtyre përmbajtjeve ishte “lajmi i rremë,” i cili përbënte 31% të totalit të rastëve të identifikuar. Temat kryesore që kanë tërhequr vëmendjen e shpërndarësve të dezinformatave përfshinin armatosjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe ngjarjet politike rreth urës së Ibrit. Raportet mbi FSK-në ishin veçanërisht të pranishme, duke zënë 13% të të gjitha përmbajtjeve të analizuar. Ky interes i veçantë tregon se çështjet e sigurisë dhe zhvillimet politike janë në fokus të informacionit të keq, duke ngjallur shqetësime mbi ndikimin që ato mund të kenë në perceptimin publik dhe stabilitetin e shoqërisë.

Platformat më të përdorura për shpërndarjen e këtyre lajmeve të rreme ishin Facebook dhe TikTok, me përkatësisht 31% dhe 23% të përmbajtjeve të shpërndara në to. Një përqindje e konsiderueshme prej 58% e informacionit të keq u shpërnda përmes mediave sociale, duke theksuar rëndësinë e këtyre platformave si kanale kryesore të dezinformatave. FSK, KFOR-i dhe BE-ja janë tre institucionet më të përfolura në përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe, ndërsa Albin Kurti është figura më e përfolur në këto përmbajtje gjatë muajit gusht 2024, së bashku me personalitete të tjera.

Analiza e 71 përmbajtjeve keqinformuese në Kosovë ka zbuluar se 13 prej tyre (18%) ishin publikuar në gjuhën serbe, me teoritë konspirative që dominonin me 8%. Dezinformatat përbënin 7%, ndërsa lajmet e rreme ishin 3% e totalit. Temat kryesore përfshinin çështje që lidhen ngushtë me Serbinë dhe veriun e Kosovës, ku veriu kishte 7% të fokusit. Situata në lidhje me urën e lbrit dhe dëbimin e serbëve kontribuan secila me 3% të përmbajtjes, duke reflektuar tensionet e vazhdueshme ndëretnike. Çështje si kërcënimet ndaj ambasadave serbe në Evropë, vendbanimet me shumicë serbe, Masakra e Reçakut, dhe protesta në Bujanoc ishin përmendur nga 1% e rasteve.

Në aspektin e fushave, temat e sigurisë përbënin 11% të përmbajtjeve keqinformuese, duke theksuar rëndësinë e tyre në kontekstin aktual, ndërsa politika kishte një peshë prej 7%. Media reale kontribuoi me 11% të përmbajtjeve të identifikuara si keqinformuese, ndërsa media sociale zuri 6%, duke e theksuar rolin e saj në shpërndarjen e informacionit të pasaktë. Personalitetet më të përmendura ishin kryeministri Albin Kurti dhe Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe, të cilat u përmendën secila në 3% të rasteve, ilustruar ndikimin e tyre në diskursin publik dhe në teoritë konspirative që qarkullojnë në mediat serbe.

HIBRIDO.INFO